



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 400-01/35429, datë: 28 Maj 2024.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, pika d) dhe nenit 40 pika j) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, datë: 04. Qershor 2008, në bazë të nenit 7 dhe nenit 18 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe nenit 77 paragrafi 2, të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-41341 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës, në propozim të kryetarit të komunës, në takimin e mbajtur me datë: **28 Maj 2024**, merr këtë:

V E N D I M
Nr. 12/2024

Nisma për bashkëpunim komunal ndërkombëtar mes Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit.

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Pejës për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar.
2. Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar do të zhvillohet me komunat si në vijim:
 - 2.1. Komuna e Pejës, Republika e Kosovës dhe
 - 2.2. Komuna Ulqinit, Republika e Malit Zi.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet për përgaditjen e propozim-marrëveshjes për bashkëpunim komunal ndërkombëtar, në fushën e turizmit, kulturës, artit dhe muzikës.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1. MAPL.
- 1x1. Kryetarit të Komunës.
- 1x1. Arkiv.

